



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 621 Prot.

Tiranë, më 17.05.2021

VENDIM

Nr.52, datë 17.05.2021

“PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR MBI ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË KONKURRIMET E PLANIFIKUARA PËR T’U ZHVILLUAR NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE GJATË VITIT 2021, ME PROCEDURAT E PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV NË SHËRBIMIN CIVIL, LËVIZJES PARALELE, NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND)”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 1, datë 05.01.2021, *“Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2021”*, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i *“mbikëqyrjes së orientuar”*, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2021.

Për këtë arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/*

inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 03.01.2018, “*Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2020*”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2021,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2021.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

1. Altin Shumeli	Drejtor i Mbikëqyrje
2. Matilda Idrizaj	Inspektor (Anëtar)
3. Behare Hoxha	Inspektor (Anëtar)
4. Ina Skënderi	Specialist IT (Anëtar)

2. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
3. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha